



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
LUSHNJE**

ANALIZË

**E TREGUESVE KRYESORË TË PUNËS PËR VITIN 2016,
TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
LUSHNJE**

DREJTUAR

**PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
Z. ADRIATIK LLALLA**

TIRANË

I nderuar z. Prokuror i Përgjithshëm!

Në mbyllje të vitit 2016 në zbatim të detyrimeve ligjore nëpërmjet këtij materiali Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje paraqet arritjet dhe objektivat e realizuar gjatë ushtrimit të ndjekjes penale si në fazën e hetimit paraprak dhe në gjykim, kryerjen e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore si dhe analizon treguesit sasiorë dhe cilësorë në përgjithësi dhe në veçanti për secilin prej tyre.


Gjatë këtij viti janë trajtuar me përparësi çështjet më problematike që shqetësojnë komunitetin e këtij rrethi, si: veprat penale kundër jetës e shëndetit, në veçanti veprat penale për dhunën në familje, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga nëpunësit shtetërorë, etj.

Në këtë kuadër, duke zbatuar detyrimin kushtetues si autoriteti i vetëm për ushtrimin e ndjekjes penale, kemi qenë të angazhuar për të kryer një hetim sa më të plotë dhe të gjithanshëm për të gjitha procedimet e trajtuara gjatë këtij viti, për të ngritur dhe përfaqësuar sa më mirë akuzën në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave dhe për të mbikqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit të të dënuarve.

VOLUMI I PUNËS NË HETIM GJATË VITIT 2016


	Mbartur		Persona nën hetim	Të pandehur	Arrest në burg	Regjistruar		Persona nën hetim	Të pandehur	Arrest në burg	Rifilluar	Persona nën hetim	Të pandehur	Arrest në burg
	Procedime	Kallëzime				Kallëzime	Procedime							
2013	88	25	21	34	15	1113	814	227	293	137	14	1	2	1
2014	229	27	49	113	27	1447	964	232	401	143	6	1	1	1
2015	252	64	136	-	10	1464	981	272	461	147	16	2	-	1
2016	229		67	91	30	1481	936	155	365	116	5	7	1	-

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike përhapja e veprave penale në rrethin e Lushnjes gjatë vitit 2016:



Në një këndvështrim të përgjithshëm rezulton se veprat penale më të përhapura dhe me tendencë në rritje gjatë këtij viti kanë qenë vjedhjet e pasurisë, kryesisht të pasurisë së shtetasve, lokale, dyqane, banesa, automjete: **354** procedime nga **378** procedime në vitin 2015; veprat penale kundër jetës dhe shëndetit: **87** procedime nga **120** të tilla në vitin 2015; shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, veprat penale në fushën e mbajtjes dhe tregëtimit të narkotikëve, të zhvillimit të palejuar të lojrave të fatit, etj.

Konkretisht, figurat e veprave penale më të përhapura gjatë vitit 2016 janë si më poshtë:



Hetimet e kryera për këto kategori veprash tregojnë se shkaqet e përhapjes së tyre janë të ndryshme, sociale dhe ekonomike, probleme të infrastrukturës dhe edukimit të pamjaftueshëm në respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesit e mjeteve, por edhe nga shtetasit, mosfunksionimi i rregullt i strukturave të ndryshme shtetërore që mbikqyrin veprimtari të palejuara dhe në shkelje të ligjit, etj.

HETIMI

	Procedime të përfunduara	Dërguar në gjyq	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Të pandehur	Persona nën hetim	Arrest në burg	Mbartur	Persona nën hetim	Arrest në burg
2013	688	293	106	269	20	329	104	126	229	146	27
2014	947	438	163	324	22	515	146	161	252	136	10
2015	1020	418	142	442	18	464	143	119	229	136	29
2016	942	411	171	348	12	456	108	121	230	106	23

PROCEDIMET PENALE TË PUSHUARA

	Gjithsej	Mungesë fakti	Mungesë prove	Shkaqe të tjera	Persona nën hetim			
					Mungesë fakti	Mungesë prove	Shkaqe të tjera	Arrest në burg
Procedime penale të pushuara	171	111	15	45	61	29	18	4

Cështjet e pushuara zënë rreth 18,2 % të numrit të përgjithshëm të çështjeve të përfunduara në periudhën 1 vjeçare, me një rritje rreth 4,3 % nga viti i kaluar.

Numri më i madh i çështjeve të pushuara është “për mungesë fakti” ku përfshihen si rastet kur është konstatuar se fakti nuk ekziston ashtu edhe ato kur fakti nuk përbën veprë penale.

Duke analizuar procedimet e pushuara për mungesë të faktit dhe të elementëve të veprës penale, konstatohet se është i nevojshëm një verifikim paraprak dhe një vlerësim më i drejtë i fakteve të paraqitura në materialin kallëzues. Vetëm në këtë mënyrë do të evitohet regjistrimi i procedimeve pa pasur bazën e mjaftueshme ligjore dhe do të respektohen liritë dhe të drejtat e personave të kallëzuar.

Çështjet e pushuara për mungesë të provave zënë vetëm 8,8% të numrit të çështjeve të pushuara çka tregon për përpjekjet e bëra për të provuar akuzat në ngarkim të personave ndaj të cilëve ushtrohet ndjekje penale.

Ndër çështjet e pushuara “për shkaqe të tjera procedurale” vendin kryesor e zënë ato që kanë të bëjnë me heqjen dorë nga ankimi prej të dëmtuarve për ato procedime ku ndjekja penale është e kushtëzuar nga vullneti i tij.

Në vitin 2016 janë ankimuar në Gjykatë 9 vendime pushimi procedimi penal, nga të cilat për 4 është vendosur prishja e vendimit të pushimit dhe kthimi i çështjes për hetim, 2 vendime janë lënë në fuqi, ndërsa për 3 vendimet e tjera gjykimi nuk ka përfunduar.

Gjatë vitit 2016 nga Drejtuesi i Prokurorisë janë shfuqizuar dy vendime mosfillimi procedimin penal dhe një vendim pushimi procedimi, të cilat pas kryerjes së veprimeve të tjera hetimore janë pushuar.

PROCEDIMET PENALE TE PEZULLUARA

Gjatë vitit 2016 janë pezulluar **348** procedime penale ose 36,9% e çështjeve të përfunduara me një ulje rreth 6,4% nga viti i kaluar. Numrin më të madh të procedimeve penale të pezulluara e zënë procedimet për veprën penale të “Vjedhjes” (neni 134 i K.Penal).

Është synuar që vendimet e pezullimit të merren pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore duke i kushtuar rëndësi të veçantë kryerjes së veprimeve në vendin e ngjarjes, fiksimit të provave në formën e parashikuar në ligj, etj. Për këtë qëllim në zbatim edhe të Udhëzimit të Përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm janë zhvilluar takime periodike me oficerët e Seksioneve dhe Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe drejtuesit e tyre për përmirësimin cilësor të kryerjes së veprimeve hetimore në fazën e hetimit paraprak.

Rrjedhojë e kësaj janë rezultatet e arritura këtë vit në zbulimin dhe dënimin e autorëve të disa veprave penale, kryesisht vjedhje të pasurisë.

Gjithsesi, megjithëse ky tregues rezulton të jetë në ulje, duke iu referuar faktit se numri i procedimeve penale të pezulluara mbetet ende i lartë, duhet pranuar se ka ende mungesë profesionalizmi nga oficerët e Policisë Gjyqësore të caktuar dhe se nuk ka një evidentim të qartë të kontigjentit kriminal. Ky fakt bën që shpeshherë të gjendemi të papërgatitur për të orientuar hetimin në ngjarjet kriminale dhe të mos arrijmë të identifikojmë autorët. Kjo kërkon medoemos një koordinim më të mirë të punës midis strukturave të policisë, por edhe ndërmjet prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Në këtë kontekst është e nevojshme dhe rritja e rolit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimin paraprak duke qenë me afër policisë në ngjarjet e rënda kriminale, por dhe duke kontrolluar në vazhdimësi ligjshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore nga ana e tyre.

Në vazhdimësi të punës së mirë të filluar që në vitin e kaluar edhe këtë vit janë rifilluar hetimet për 7 procedime të viteve të mëparshme, 5 prej të cilave kanë qenë të pushuara dhe 2 kanë qenë të pezulluara për moszbulim autori.

PROCEDIMET E DËRGUARA PËR GJYKIM

Në vitin 2016 janë dërguar për gjykim **411** procedime penale ose 7 procedime më pak se vitin e kaluar, me 456 të pandehur nga të cilët 117 të arrestuar dhe pjesa tjetër të ndjekur me masa të tjera sigurimi. Procedimet penale të dërguara për gjykim zënë rreth 43,6% të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të përfunduara (llogaritja është bërë duke marrë në konsideratë të gjitha çështjet e përfunduara: dërguar gjyqit+të pushuara+të pezulluara+ të transferuara). Pra, rezulton se përqindja e procedimeve të dërguara për gjykim në raport me totalin e procedimeve të përfunduara është 2,6% më e lartë se në vitin 2015.

Sic shihet treguesit e çështjeve të dërguara në gjyq janë në parametra pozitive duke ju përmbajtur gjithmonë parimit për të dërguar në gjyq ato procedime për të cilat ka pasur një bazë të mjaftueshme të dhënash hetimore paraprake për provueshmërinë e akuzës në ngarkim të personave të pandehur. Për veprat penale të rënda si: krimet kundër personit, pasurisë, por edhe për vepra të tjera të përhapura në rrethin tonë hetimet ndaj autorëve të dërguar për gjykim janë ndjekur në gjendje arresti.

Gjatë vitit 2016 janë hetuar 5 procedime për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, nga të cilat për 3 është vendosur pushimi i procedimit, 1 është dërguar për gjykim, ndërsa procedimi tjetër është ende në hetim.

Po kështu janë dërguar për gjykim edhe mjaft procedime për veprat penale të organizimit të llotarive të palejuara, për fallsifikim të dokumenteve, vjedhje të pasurisë, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, etj.

Nga procedimet e dërguara për gjykim pjesën kryesore e zënë procedimet e regjistruara mbi bazën e materialeve të referuara nga organet e Policisë së Shtetit si dhe nga qytetarët. Gjithashtu, në vitin 2016 është dërguar për gjykim një procedim penal i filluar në vitet e mëparshme mbi bazën e kallëzimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për të cilin gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurve.


Nga K.L.Sh. gjatë vitit 2016 janë bërë 3 kallëzime penale për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të cilat janë në hetim, ndërsa nga I.L.D.K.P.K.I. nuk ka pasur asnjë kallëzim penal.

Për vitin 2016 është vendosur mosfillimi për **553** procedime penale ose për **56** kallëzime më shumë se viti **2015**. Për të gjitha këto raste është treguar kujdesi i duhur që vendimi të merret pasi të jenë kryer verifikimet e nevojshme dhe brenda afatit të përcaktuar në urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm. Përgjithësisht është respektuar ky afat me përjashtim të disa rasteve kur vonesat kanë ardhur për shkaqe objektive, siç është rasti i vonesave të akteve të ekspertimit, kryesisht mjeko-ligjore, por në raste të veçanta edhe për neglizhencë nga oficerët e policisë gjyqësore të ngarkuar për të kryer verifikimet apo edhe nga vetë prokurorët. Mendojmë se politika e ndjekur në rastet e vendimeve të mosfillimit ka shërbyer jo vetëm për të mos harxhuar energji të panevojshme, por edhe për të parandaluar fillimin e ndjekjes penale ndaj personave të cilët në fakt nuk dyshohen të kenë kryer ndonjë vepër penale. Në zbatim të detyrimeve të ligjit procedural penal të gjithë personave të interesuar u janë komunikuar vendimet e mosfillimit duke u dhënë atyre mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatë.

Nga procedimet penale të mosfilluara janë ankimuar në Gjykatë **17** prej tyre. Gjykata ka lënë në fuqi vendimet e mosfillimit në **9** raste, ka pranuar ankimin në **4** raste, ndërsa 4 ankimet e tjera janë ende duke u shqyrtuar.

Objektivi ynë për çështjet e mbartura është që të përfundojnë brenda tremujorit të parë të vitit 2017.

Më poshtë paraqitet grafikisht krahasimi mes numrit të çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2014, 2015 dhe 2016 sipas mënyrës së përfundimit:



HETIMI PARAPRAK

Masat e sigurimit provizore

Arrest në flagrancë	Ndalime nga Pol.Gjyqësore	Urdhër ndalimi të Prokurorit	Gjithsej	Urdhër lirimi të menjëhershëm	Kërkesa për vlerësim	Vlerësime të ligjshme	Vlerësime të paligjshme
260	35	5	300	12	288	266	22

Për këta tregues është kërkuar respektimi me korrektesë i kriterëve të përcaktuara në ligjin procedural penal si dhe garantimi i të drejtave të personave që u është hequr liria duke kushtuar një kujdes të veçantë sidomos për respektimin e garancive që u siguron ligji personave të mitur. Në analizën e treguesve bie në sy fakti që në **22** raste nga **288** gjithsej janë vlerësuar të paligjshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë. Në gjykimin tonë kjo ka ndodhur për dy arsye:

Së pari, për zbatim të gabuar të ligjit procedural penal nga oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të Policisë së Shtetit.

Së dyti, për shkak të mungesës së kontrollit nga prokurorët dhe në ndonjë rast për vlerësim jo të drejtë nga Gjykata e Shkallës së Parë, siç janë rastet e arrestimeve me disa orë vonesë nga policia, të cilat janë konsideruar të paligjshëm nga gjykata.

Masat e sigurimit

	Arrest në burg	Arrest në burg në mungesë	Arrest në shtëpi	Arrest në burg me afat	Garanci pasurore	Detyrim për paraqitje	Masa ndaluese
Kërkuar nga Prokuroria	126	12	0	2	1	151	15
Vendosur nga Gjykata	117	12	3	1	6	153	15

Apelet ndaj masave të sigurimit

Apel	Gjithsej	Zgjidhja nga Gjykata e Apelit Vlorë				
		Shfuqizim Vendimi	Nd/Vend. Sipas Apel/Prok	Nd/Vend M.Sig më të Butë	Mirat. Ven d. që Pran.K/Pr	Mirat. Ven d. që Rrëzon.K/Prok.
Nga Prokuroria	4	-	-	4	35	4
Nga i Pandehuri	47					

TREGUESIT E PUNËS PËR VITIN 2016

Procedimet penale dhe materialet referuese që janë hetuar nga secili prej prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore gjatë vitit 2016, janë si më poshtë:

Prokurori	Procedime penale të hetuara	Dërguar në gjyq	Pushuar	Pezulluar	Shpallur moskompetenca	Mosfillime	Mbartur
Çlirim Shahini	21	5	2	12	-	36	2
Arens Çela	2	-	2	-	-	-	-
Merita Selimi	230	81	40	80	2	105	27
Arben Dyla	227	91	31	64	2	112	39
Skënder Mestani	174	47	27	18	2	34	80
Artan Hazbi	226	97	32	78	3	127	16
Rovena Bozo	215	75	33	78	3	111	26
Natasha Shallapi	77	15	4	18	-	30	40

Drejtuesi i Prokurorisë:

Është përpjekur të përmirësojë organizimin e brendshëm të punës dhe disiplinën e punës në Prokurori me qëllim rritjen e kontrollit ndaj punës së prokurorëve për procedimet penale që ata kanë në hetim dhe gjykim, por edhe duke marrë pjesë vetë që në momentet e para për ngjarjet e rënda kriminale dhe duke ndihmuar në zgjidhjen konkrete të tyre.

Në këtë kuadër i ka kushtuar një kujdes të veçantë trajtimit të të gjitha materialeve kallëzuese, regjistrimit të procedimeve penale, shpërndarjes së një ngarkese uniforme për të gjithë prokurorët, kontrollit gjatë fazës së hetimeve, kontrollit të çështjeve në momentin e përfundimit të tyre duke u kujdesur që vendimet e marra të jenë në përputhje me ligjin dhe për çështjet e dërguara në gjyq të zbatohet një politikë penale e unifikuar duke vlerësuar rrezikshmërinë e veprave penale dhe të autorëve, por edhe përhapjen e tyre në territorin ku Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallësë së Parë Lushnjë ushtron funksionet e saj.

Zëvendësimi i prokurorëve është bërë në rastet e largimit të prokurorëve për shkak transferimi në një prokurori tjetër dhe për marrjen e lejes së barrë-lindjes. Edhe zëvendësimi i oficerëve të policisë gjyqësore është kryer për të njëjtat shkaqe dhe vetëm në ndonjë rast të veçantë për zvarritje të hetimit apo për shkaqe të tjera.


GJYKIMI

Mbartur në gjykim	Dërguar në gjyq	Të pandehur	Arrest në burg	Përfunduar gjykim	Të pandehur	Arrest në burg	Gjykim i drejtpërdrejtë	Gjykim i shkurtuar	Gjykim i zakonshëm	Mbartur në gjykim	Të pandehur	Arrest në burg
-------------------	-----------------	-------------	----------------	-------------------	-------------	----------------	-------------------------	--------------------	--------------------	-------------------	-------------	----------------

Viti 2016	141	411	627	158	386	432	127	37	333	52	166	195	31
----------------------	------------	------------	------------	------------	------------	------------	------------	-----------	------------	-----------	------------	------------	-----------

	<i>Kërkuar nga Prokuroria</i>	<i>Vendosur nga Gjykata</i>
Burgim	166	171
Gjobë	59	51
Pezullim	192	185
Tërheqje akte	4	4
Pushimi i akuzës	-	-
Pushimi i çështjes	11	13
Pafajësi	0	8

Më poshtë paraqiten grafikisht llojet e dënimeve të kërkuara nga prokurorët dhe mënyra se si ka vendosur gjykata.



Për vitin 2016 është dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje pafajësi në **4** procedime (me 5 të pandehur), ndërsa për 3 të pandehurit e tjerë pafajësia nuk është dhënë për të gjithë procedimin. Asnjë nga të pandehurit që janë deklaruar të pafajshëm nuk ka qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Në krahasim me vitin 2016 numri i procedimeve për të cilat është dhënë pafajësi është i njëjtë me atë të vitit të kaluar.

Më konkretisht, janë deklaruar të pafajshëm të pandehurit:

- 1. Hamza Feti**, hetuar në gjendje të lirë, i akuzuar për veprën penale parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, procedim i cili është dërguar në

gjq nga prokurori **Petrit Çano** dhe pas transferimit të tij është përfaqësuar në gjykim nga prokurore **Merita Selimi**.

2. **Kristo Dhaskali**, hetuar në gjendje të lirë, i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni **143/2 i K.Penal**, procedim që i përket prokurorëve **Natasha (Shallapi) Prifti e Arben Dyla**.
3. **Indrit Çoku**, hetuar pa masë sigurimi, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni **89-25 i K.Penal**, procedim që i përket prokurorit **Skënder Mestani**, ndërsa dy të pandehurit e tjerë të këtij procedimi janë deklaruar fajtorë.
4. **Hysen Hida**, hetuar pa masë sigurimi, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 200 i K.Penal, procedim që i përket prokurorit **Skënder Mestani**.
5. **Agim Kojku e Kozma Andrea**, hetuar pa masë sigurimi, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet **186/3 e 186/2 të K.Penal**, procedim që i përket prokurores **Rovena (Bozo) Zoto**.
6. **Hysen e Baftjar Meçi** hetuar pa masë sigurimi, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni **200 të K.Penal**, procedim që i përket prokurorit **Arben Dyla**, ndërsa tre të pandehurit e tjerë të këtij procedimi janë deklaruar fajtorë.

Të gjitha këto raste janë ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, por për asnjërin prej tyre nuk ka përfunduar gjykimi. Pas përfundimit të gjykimit në Apel të gjitha këto raste do t'u nënshtrohen analizave për të përcaktuar edhe përgjegjësitë përkatëse të secilit prokuror, në veçanti të prokurorëve që kanë më shumë raste.

Gjithsesi, ky tregues, pavarësisht pretendimeve që kemi për bazueshmërinë e vendimeve të gjykatës, duhet të merret në konsideratë për të bërë kujdes në sigurimin e provave në hetimin paraprak, por edhe për rritjen e rolit të prokurorit gjatë shqyrtimit gjyqësor, sidomos në fazën e administrimit të provave.

Për fazën e gjykimit i është kushtuar rëndësi sigurimit të provave të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve si dhe diferencimit të llojit dhe masës së dënimit në varësi të veprës penale të kryer.

Për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si ato kundër jetës dhe shëndetit, vjedhjet, mashtrimet, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, veprat penale në fushën e narkotikëve, etj. kërkesat tona për llojin dhe masën e dënimit kanë qenë të tilla që t'i shërbejnë parandalimit dhe ndëshkimit të këtyre veprave penale.

Gjithsesi, duke analizuar gjithë treguesit e këtij viti mendoj se është e nevojshme që politika e dënimit të përmirësohet në vijimësi duke e bërë më fleksibël dhe duke e përshtatur me format dhe tendencat e kriminalitetit në rrethin tonë.

Gjatë vitit 2016 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje nuk është depozituar asnjë kërkesë-padi për kompensim për burgim të padrejtë.

Gjatë vitit 2016 kanë qenë **17** rastet kur prokurorët kanë apeluar vendimin e Gjykatës.

Gjithashtu janë ushtruar nga prokurorët edhe apele kundërshtues për shkaqe të ndryshme. Këto akte kanë pasur një ndikim pozitiv mbasi u kanë prerë rrugën apeleve të pabazuara të të pandehurve ndaj vendimeve gjyqësore të shkallës së parë.

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE

Prokuroria e pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer edhe detyrimet procedurale në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale. Gjatë vitit 2016 të ngarkuar me këtë detyrë kanë qenë prokurorët **Merita Selimi** dhe **Skënder Mestani** të cilët kanë urdhëruar ekzekutimin e **395** vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Vendime	Dënim me burg		Dënim me gjobë		Dënime plotësuese		Neni 59 K.P.		Neni 63 K.P		Masa mjekësore	Prova materiale	Shpenzime procedurale
	Urdhra	Ekzekutuar	Urdhra	Ekzekutuar	Urdhra	ekzekutuar	Urdhra	Ekzekutuar	Urdhra	Ekzekutuar			
395	84	74	67	63	29	25	136	100	32	23	13	80	339

Gjithashtu janë ndjekur rregullisht në gjykatë edhe ankimet e të dënuarve gjatë fazës së ekzekutimeve. Problem mbetet ende ekzekutimi i dënimeve me gjobë, por në ndonjë rast edhe për moskryerje të detyrës nga organet përmbarimore.

Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë

Gjatë vitit 2016 janë përfunduar procedurat e ekstradimit për jashtë shtetit për **1** të dënuar dhe për **2** raste njohje vendimi penal të huaj.

VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

Gjatë vitit 2016 vijoi kryerja e detyrave në përputhje me ligjin organik dhe Udhëzimin e Përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm me Ministrin e Brendshëm për

funksionimin e Policisë Gjyqësore. Konstatohet se me gjithë problemet e vogla që janë hasur në zbatim të tij ky udhëzim ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e punës. Ka ardhur në përmirësim kryerja e hetimeve paraprake nga oficerët e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore, falë edhe kontakteve më të ngushta që janë vendosur mes tyre, prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë. Është fakt që një numër i madh veprash penale janë hetuar nga oficerët e këtyre shërbimeve.

Karakteristikë për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje është mirëkuptimi i plotë dhe bashkëpunimi i ngushtë me drejtuesit e Policisë vendore dhe besojmë se rrjedhje e këtij bashkëpunimi në interes të detyrës tonë të përbashkët janë rezultatet e arritura dhe ato që pretendojmë të arrijmë në të ardhmen. Ndërkohë që kërkohet një bashkëpunim më i mirë me Zyrat Rajonale të Drejtorisë së Policisë Fier të cilat nuk i ushtrojnë si duhet funksionet e tyre në rrethin e Lushnjes.

Gjatë vitit 2016 nuk ka pasur raste që ndaj prokurorëve të jenë marrë masa disiplinore. Pavarësisht kësaj, duke trajtuar me shumë seriozitet shqetësimet e ngritura nga palët në proces apo qytetarët, është kërkuar në vazhdimësi që prokurorët të jenë korrekt me qytetarët, me vartësit, me kolegët, të ruajnë një figurë të pastër etiko-morale duke i shërbyer në radhë të parë vetes, por edhe ruajtjes së një imazhi të pastër të Institucionit. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe transparenca e reflektuar me qytetarët, por edhe me median kur këto të fundit kanë shfaqur interes për çështje konkrete të veprimtarisë së organit. Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në R. Shqipërisë dhe nga Ligji “Për Policinë Gjyqësore” megjithëse Komisioni Disiplinor ka qenë i ngritur nuk ka pasur procese disiplinore ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore. Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Urdhëri i Prokurorit të Pergjithshëm “Për organizimin e mbledhjeve të prokurorëve” dy herë në muaj janë zhvilluar me seriozitet mbledhjet me gjithë trupën e prokurorëve dhe oficerëve të Policisë gjyqësore me tematikë të përcaktuar duke trajtuar problemet që kemi hasur në praktikën e përditshme.

Është me vend të theksojmë edhe përkushtimin e treguar nga personeli administrativ i kësaj prokurorie, puna e të cilëve ka qenë mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore në ushtrim të detyrës së tyre, por edhe për qytetarët të cilëve u janë ofruar shërbime administrative të cilësisë së lartë.

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, për të ardhmen prioritetet tona kryesore do të jenë:

1. Përfundimi brenda tremujorit të parë të vitit **2017** të të gjitha çështjeve të mbartura nga viti **2016**.
2. Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale kundër pasurisë, veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimit me detyrën të nëpunësve shtetërorë, veprat penale kundër jetës, shëndetit, kundër rendit dhe sigurisë publike, në veçanti shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor dhe çdo lloj forme tjetër të krimit që konsiderohet shqetësuese për komunitetin ku ushtrojmë detyrën.

3. Rritja e përpjekjeve nga prokurorët për të bërë të mundur rritjen e koeficientit të zbulueshmërisë së veprave penale, përmirësimi i treguesve të pafajësisë, ndryshimit të pamotivuar të cilësimit ligjor të veprave penale, aplikimin e një politike penale të ndëshkimit të fajtoresve që t'u përgjigjet nevojave të një lufte sa më efektive kundër kriminalitetit.
4. Ndjekja në vazhdimësi e çështjeve për ngjarje kriminale të rënda të pezulluara në vitet e mëparshme, në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet policore me qëllim për të mos lejuar askënd t'i shpëtojë ndëshkimit ligjor për veprat e kryera.
5. Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimet paraprake të kryera nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore.
6. Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit brenda organit të Prokurorisë për t'ju përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave të luftës kundër kriminalitetit. Respektimi i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
7. Rritja e profesionalizmit të prokurorëve dhe ruajtja e një figure morale të pastër jashtë çdo ndikimi.

DREJTUESI I PROKURORISË

ÇLIRIM SHAHINI

KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj. ¹	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja:						3				
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër										
Neni 78 Vrasja me paramendim	1	1	2	2	-	1		2		2
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje										
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	1					1	1	1	1	
Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë										
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit										
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare						1				
Neni 80										
Neni 81 Vrasja e foshnjës										
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike										
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme										
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje										
Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje										
Neni 84 Kanosja	6	4	3	4	3	5	1	3	2	1
Totali	8	5	5	6	3	11	2	6	3	3

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia	1	1	1	1	-					
Totali	1	1	1	1	-					

	2015	2016
--	------	------

¹ Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.

² Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. për gjykim	Nr. i Pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pandënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandënuar
Neni 86 Tortura										
Neni 87 Tortura me pasoja të rënda										
Neni 88 Plagosje e rëndë me dashje	2	-	2	-	1	3	2	3	2	1
Neni 88/a Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë psiqike										
Neni 88/b Plagosje e rëndë në kapërcim të mbrojtjes										
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	21	16	30	24	21	16	11	17	14	6
Neni 89/a										
Neni 90 Dëmtime të tjera										
Totali	23	16	32	24	22	19	13	20	16	7

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia										
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia										
Totali										

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas										
Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz.										
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë										
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm						1	1	1	1	
Neni 97 Mosdhënia ndihmë										

Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes				
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	1		1	
Totali	2	1	2	1

KRIME SEKSUALE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur	4	2	4	2	2					
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç						1		1		
Neni 102 M. Seksuale me dhunë me të rritura										
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë me të rritur										
Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur	1	-	1	-	-					
Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksualeme kërkënim me përdorimin e armës										
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shpërdoruar detyrën										
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari										
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike										
Neni 108 Vepra të turpshme	2	2	2	2	2					1
Neni 108/a Ngacmimi seksual	1	-	1	-	-	1				
Totali	8	4	8	4	4	2		1		1

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 109 Rrembimi ose mbajtja peng e personit										
Neni 109/a Rrembimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese										
Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise	1	-	-	-	-					
Neni 109/c Zhdukja me forcë										
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë	1	-	-	-	5	2		1		

Neni 111 Rrebbimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera							
Neni 112 Dhunimi i baneses							
Totali	2	-	-	-	5	2	1

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT	2015					2016				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denu ar	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim m	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denu ar
Neni 113 Prostitucioni				3	1					3
Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit	3	1	1	2	4	3		3		2
Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion										
Neni 117 Pornografia										
Neni 118 Dhunimi i varreve										
Neni 119 Fyerja										
Neni 120 Shpifja										
Neni 121 Ndërrhyrje të padrejta në jetën private										
Neni 121/a Përndjekja	2	2	2	2	2					1
Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake										
